

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"U krijua për transplant organesh por mori drejtim tjetër"-avokati Selimaj sqaron rolin e Hagës - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/u-krijua-per-transplant-organesh-por-mori-drejtim-tjeter-avokati-selimaj-sqaron-rolin-e-hages/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 11:59:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 11:56:20 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6d8aaa5b4e8f4c689eac4f81b8d56db86b29e542b275b592d333be67fd72d4c3
TEKSTI	6286d52b058d03f31d3f06ab2e8655969663719abf5446264f2043cf2c743f1c
PAMJA	ea22d8bedde20f81dfdb806c2d7f7f984cd8a712db0eb2da3aaf9c1af44c1d1b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2b756272cfa3629f019df8e368920de0d1375313db37aa26bfe4c0c5860bfdb0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4f41e4bbd5d1a7a4ac13493ee37230fd53ce6e6428b4fbf05933a9d422fc171d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/2b756272cfa3629f019df8e368920de0d1375313db37aa26bfe4c0c5860bfdb0

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Gjyqi i UÇK Meshar Selimaj Jakup Krasniqi Arabia Saudite Rusia

EURONEWS NOW ME ESMERALDA MULAJ | KOSOVË

“U krijua për transplant organesh por mori drejtim tjetër”-avokati Selimaj sqaron rolin e Hagës



18 Shtator 2026 | 13:56

Avokati Meshar Selimaj në Euronews Albania ka trajtuar disa nga pikat kryesore lidhur me punën dhe vendimet e Gjykatës Speciale të Hagës.

Avokati shprehet skeptik ndaj punës së gjykatës duke e cilësuar të paligjshme dhe joetike përmendjen e emrave të personave që nuk janë palë apo subjekte në atë procedurë.

“Që prej fillimit personalisht kam qenë skeptik rreth kundër kësaj gjykate e cila shihet që ka qëllim dënimin dhe, për aq më keq, është e paligjshme, e panevojshme, jo etike, jo ligjore, jo racionale që në një shpallje të një vendimi kjo gjykatë të përmend edhe emra të tjerë të personave të cilët nuk kanë gjykuar në atë rast, të personave të cilët nuk janë subjekte procedurale as nuk janë palë në atë procedurë. Pra kjo përbën një mangësi të thellë dhe një paragjykim të rastit në përgjithësi dhe të rasteve të tjera që ndoshta mund të vijnë në të ardhmen, për shkak se përmendja e emrave jashtë katërsheve të UÇK-së lind shumë dilema dhe dyshime se ndoshta çfarë ishte, sepse ne e dëgjuam përmendi Fatmir Limajn, përmendi Lahi Brahimajn, Rrustem Mustafën e të tjerë, por Lahi Brahimaj dhe Fatmir Limaj kanë kaluar njëherë në tribunalin e Hagës.

Pra ata janë, dhe jo vetëm një herë, janë hetuar, gjykuar, janë shpallur të pafajshëm për çështje që lidhen me luftën. Pse ky gjyqtar duhet t’i risillte emër për emër? Unë e kam thënë edhe ditën kur ka ndodhur shpallja: mos është një mesazh ogurzi nga ai zyrtar i cili po paralajmëron marrjen e veprimeve të mëtejshme të kësaj prokurorie?”.

Avokati kritikon ashpërsinë e dënimeve ku sipas tij, duhej të aplikohesh ligji më i favorshëm i kohës kur pretendohet se janë kryer veprat, ku dënimi maksimal me burgim arrinte deri në 15 vjet.

“Veprimet në vazhdim të kësaj gjykate e kanë pasur prej fillimit, në vazhdim edhe tutje kanë një qëllim: denigrimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, luftës së saj përmes dënimeve dhe sulmeve që i bëhen. Tash për tash është problematike se si do të vazhdojë tutje zhvillimi i kësaj procedure. Ka mosbesim në këtë gjykatë, sepse dënimet janë të ashpër dhe në kundërshtim të plotë edhe me parimin e legalitetit. Ne e kemi thënë se Kodi Penal i Jugosllavisë, i cili ka qenë për kohën kur pretendohet që janë kryer këto vepra penale, maksimumin e dënimit e ka pasur deri në 15 vite burgim”, tha ai.

Selimaj shtoi se Gjykata Speciale u themelua fillimisht me kërkesë dhe presion ndërkombëtar për të hetuar pretendimet për trafikim organesh.

LAJMI I FUNDIT

13:50 Avokati Selimaj: Gjykata e Hagës po i nxjerr vetë ligjet, i tejkalon proceset tona ligjore

13:47 Von der Leyen anashkalon Serbinë dhe Bosnjën në turneun e saj në Ballkan

13:35 7 të arrestuar dhe mbi 6800 gjopa në 72 orë, Policia Rrugore e Tiranës shton kontrollet

SHPËRNDAJE
ARTIKULLIN Turqia miraton marrëveshje bashkëpunimi me Brazilin në industrinë e mbrojtjes

13:29 Aktori turk dhe ish-lojtari i Galatasaray-t midis 16 të arrestuarve në bastisjet e drogës në Stamboll

13:23 Po kujdesej për bimët narkotike në mes të pyllit, arrestohet 37 vjeçari në Mirditë

TESTIM

“Kjo gjykatë është themeluar për transplant të organeve, hetimin e krimeve të pretenduara për trafikim me organe dhe ka pësuar një metamorfozë në diçka tjetër komplet. Dhe kjo është një padrejtësi e radhës të cilën ne e marrim. Ne si shqiptarë jemi përcjellë vazhdimisht në këto lloj pabesish edhe historikisht”, tha Selimaj.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

EURONEWS NOW ME ESMERALDA MULAJ | KOSOVË | RAJONI | VENDI | VIDEO

Avokati Selimaj: Gjykata e Hagës po i nxjerr vetë ligjet, i tejkalon proceset tona ligjore

Avokati, Meshar Selimaj në një lidhje live me gazetaren e Euronews Albania, Esmeralda Mulaj ka folur lidhur me vendimin e Gjykatës së Hagës e cila...

13:50 | 18/09/2026

AKTUALITET | EURONEWS NOW ME ESMERALDA MULAJ | LAJMI I FUNDIT | VENDI

“Temperatura të larta dhe rrebeshe shiu”, meteorologia tregon si do të jetë moti këtë javë

E ftuar në një lidhje direkte me gazetaren Esmeralda Mulaj, meteorologia e Metoalb, Lajda Porja, ka bërë parashikimin e motit për ditët në vijim, duke...

14:38 | 08/09/2026

AKTUALITET | EURONEWS NOW ME ESMERALDA MULAJ | KOSOVË | LAJM KRYESOR | RAJONI

Sela zbardh detajet nga takimi me Kurtin: I tregova të vërtetën mbi Mickoskin dhe të drejtat e shqiptarëve

Kryetari i Lidhjes Shqiptare, Ziadin Sela ka folur në Euronews Albania sa i përket një takimi të zhvilluar mes tij dhe Albin Kurtit mbi situatën...

11:01 | 07/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni

Follow Euronews on all platforms: